



## HASAJ: RITJA E PAGAVE, HAP I DUHUR, POR ME SHUMË NDIKIME

| FAQE 4-5



Vendimi i Qeverisë së Kosovës për rritjen e pagave nga janari i vitit të ardhshëm është hap i duhur për Blendi Hasaj, drejtor ekzekutiv në Institutin për Hulumtime të Avancuara (GAP) në Prishtinë. Ai

ka përmendur argumentet ekonomike sipas të cilave është dashur të merret një vendim i tillë, por nuk e mohon faktin se kjo mund të përdoret edhe si fushatë parazgjedhore. Hasaj,

gjithashtu, thekson rrezikun që sektori privat të bëhet më pak tërheqës, dhe të punësuarit në këtë sektor të ballafaqohen me paga dhe kushte më të vështira në punë


**KE-ja VLERËSON PËRPARIMIN E KOSOVËS DHE E INKURAJON T'I NORMALIZOJË MARRËDHËNIET ME SERBINË** F. 3



**TË PAKTËN 62 TË VDEKUR NGA PËRMBYTJET NË SPANJË** F. 2



### AKTUALE



**FOL-i: INSTITUCIONET E PAVARURA TREGOJNË MANGËSI PËR ZBATIMIN E DISPOZITAVE LIGJORE MBI DEKLARIMIN E DHURATAVE** F. 6

**HAXHIU KËRKON HETIM URGJENT PËR MBYLLJEN E DYSHIMTË TË RASTIT TË PRONËS MILIONËSHE NË VETERNIK** F. 7

**BE-ja THOTË SE SERBIA KA SHKELUR QARTAZI OBLIGIMET NGA DIALOGU ME KOSOVËN** F. 3

### EKONOMI



**KRIJIMI I FONDIT TË INOVACIONIT TË KOSOVËS HAP RRUGËN PËR NJË EKOSISTEM INOVATIV NË VEND** F. 8

**INDEP: KOEFICIENTET TË HARMONIZOHEN ME PAGËN MINIMALE, JO ME LOJËRAT E PARTIVE PËR PUSHTET** F. 8

### SPORT



**DY NDESHJET E SUPERLIGËS PËRFUNDOJNË PA FITUES, SOT DERBI DRITA - PRISHTINA** F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Të paktën 62 të vdekur nga përmbytjet në Spanjë

VALENCIA, 30 TETOR - Të paktën 62 njerëz kanë vdekur nga përmbytjet si pasojë e shirave të rrëmbyeshme të martën në rajonin lindor të Spanjës, Valencia, njoftuan autoritetet të mërkurën.

Shirat e rrëmbyeshme gjatë ditës së martë bënë që rrugë dhe qytete të përmbytën. Pamje të publikuara në rrjetet sociale shfaqën njerëz që kanë ngecur si pasojë e përmbytjeve, disa prej të cilëve duke u ngjitur në pemë. "Për ata që ende kërkojnë të dashurit e tyre, e gjithë Spanja është me ju", tha kryeministri i Spanjës, Pedro Sanchez, në një fjalim televiziv. "Fshatrave dhe qyteteve të shkatërruara nga kjo tragjedi u them të njëjtën gjë: Së bashku do t'i rindërtojmë rrugët, sheshet, urat tuaja", tha ai.

Carlos Mazon, shefi rajonal i Valencias, tha për shtyp se disa

njerëz kanë mbetur të ngjuar në vende jo të qasshme. "Nëse [shërbimet emergjente] nuk kanë mbërritur, nuk është si pasojë e mungesës së mjeteve, por për shkak të qasjes", tha Mazon, duke shtuar se arritja në disa zona është "plotësisht e pamundur".

Shërbimet emergjente në rajon u bënë thirrje qytetarëve ta shmangin udhëtimin rrugëve dhe u kërkuan t'i përcjellin përditësimet shtesë nga burimet zyrtare.

Transporti me tren në qytetet Madrid dhe Barcelonë është anuluar për shkak të vërshimeve, ndërsa shkollat dhe shërbimet e tjera thelbësore janë pezulluar në zonat më të goditura.

Instituti Meteorologjik i Spanjës, AEMET, shpalli alarm të kuq në Valencia.

Duket se ky është numri më i madh i të vdekurve në Evropë



nga përmbytjet që prej vitit 2021, kur gati 200 njerëz vdiqën, kryesisht në Gjermani. Shkencëtarët thonë se


fatkeqësitë natyrore në rajon po shpeshtohen për shkak të ndryshimeve klimatike. Meteorologët mendojnë se

ngrohja e Mesdheut, e cila e rrit avullimin e ujit, bën që shirat e rrëmbyeshme të jenë shumë më të mëdha.

## Prokurorët nisin hetim ndaj dyshimeve për manipulim të zgjedhjeve në Gjeorgji

TBILISI, 30 TETOR - Prokurorët gjeorgjianë e kanë thirrur presidenten e vendit, Salome Zurabishvili, për të dëshmuar, pasi e nisën një hetim ndaj dyshimeve mbi manipulime në zgjedhjet e 26 tetorit, të cilat i fitoi partia në pushtet, Ëndrra Gjeorgjiane. Presidentja Zurabishvili dhe opozita ngulin këmbë se ka pasur shkelje të mëdha në këto zgjedhje. Një ditë më parë presidenti amerikan Joe Biden shprehu shqetësimin e tij të thellë për regresin demokratik të Gjeorgjisë dhe bëri thirrje për hetim transparent ndaj dyshimeve për vjedhje votash.

Partia gjithnjë e më autoritare, Ëndrra Gjeorgjiane, e shpalli fitoren me pothuajse 54 për qind të votave, duke i nxitur mijëra njerëz të protestojnë kundër



rezultatit zgjedhor, i cili, sipas tyre, u manipulua nga partia në pushtet përmes taktikave të stilit rus.

Vëzhguesit ndërkombëtarë të zgjedhjeve deklaruan se zgjedhjet u karakterizuan nga "një fushë e pabarabartë, presion dhe tension". Ata gjithashtu njoftuan për raste të regjistruara të blerjes së votave, votimit të dyfishtë, dhunës fizike

dhe kërcënimit.

Prokuroria e Përgjithshme deklaroi se hetimi ka nisur, pasi Zurabishvili deklaroi se zgjedhjet u shoqëruan me shkelje dhe refuzoi ta pranonte rezultatit të tyre. "Presidentja Salome Zurabishvili duhet të ketë prova për falsifikimin e mundshëm të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2024, në

lidhje me të cilat, në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj, [ajo] është thirrur për t'u marrë në pyetje më 31 tetor", thuhet në njoftim.

Prokurorët janë zotuar se do t'i ndërmarrin "të gjitha veprimet e nevojshme hetimore dhe procedurale, siç përcaktohet në apelin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe me qëllim të shqyrtimit të akuzave të shprehura nga presidentja e Gjeorgjisë, përfaqësuesit e partive politike dhe misionet vëzhguese". "Si pjesë e hetimit, të gjithë personat që mund të kenë informacion mbi faktet e dyshuara penale do të merren në pyetje", thanë ata.

Zgjedhjet u mbajtën disa muaj pasi Ëndrra Gjeorgjiane e miratoi një ligj të diskutueshëm për "ndikimin e huaj", të ngjashëm me

ligjin rus për "agentët e huaj," pavarësisht bojkotit të opozitës dhe protestave masive disamujore, që herë pas here u shtypën me dhunë. Ligji për kufizimin e të drejtave të komunitetit LGBT gjithashtu u miratua muajin e kaluar.

Zurabishvili, e cila ka qenë në konflikt me Ëndrrën Gjeorgjiane, por ka pushtet të kufizuara sipas Kushtetutës së Gjeorgjisë, i bëri thirrje Perëndimit në një intervistë për Radion Evropë e Lirë më 29 tetor që të ushtronte trysni ndaj Tbilisit për ta mbajtur vendin në rrugën përëndimore.

Ajo nuk pranoi ta nënshkruante ligjin për "ndikimin e huaj" dhe i kundërshtoi masat për LGBT, vendime që u rrëzuan pastaj nga Ëndrra Gjeorgjiane për shkak se ajo e ka nën kontroll Parlamentin.

## Slovakia, mijëra mjekë japin dorëheqje për shkak të kushteve të punës

Më shumë se 2 700 mjekë kanë dhënë dorëheqje nga spitalet në Sllovakia, në kuadër të një proteste të organizuar për kushtet e punës.

Sindikata e mjekëve, LOZ, ka thënë se kjo do të thotë që më shumë se gjysma e mjekëve në nivel shtetëror kanë dhënë dorëheqje nga puna në spitale. Ata janë të gatshëm që t'i tërheqin dorëheqjet nëse qeveria përmbush disa kërkesa që kanë. Aty përfshihen kërkesa për pajisje të reja mjekësore dhe punësimi i stafit shtesë.

Deri më tani nuk është arritur

asnjë marrëveshje me ministrin e ri të Shëndetësisë, Kamil Shashko. "Siç duket, mënyra e vetme për të kryer gjithçka në sistemin sllovak të shëndetësisë është dorëheqja", ka thënë udhëheqësi i sindikatës LOZ, Peter Visolajsky, para gazetarëve në Bratislavë.

Paraardhësja e Shashkos, Zuzana Dolinkova, ka dhënë dorëheqje në fillim të tetorit, duke thënë se qeveria nuk është duke bërë mjaftueshëm për ta mbështetur në forcim të sistemit shëndetësor. Shtyrsa më e madhe për dorëheqjet masive, të cilat janë

paralajmëruar që një kohë, ka qenë një program i shtrënguar, i bërë publik përgjatë verës nga qeveria e udhëhequr prej kryeministrit të krahut të majtë, Robert Fico.

Programi parasheh tërheqjen e pjesshme të premtimit për rritje të pagave të mjekëve dhe infermierëve.

Planet e qeverisë për t'i shndërruar spitalet në shoqëri aksionare kanë zemëruar ashpër sindikatat e mjekëve. Përfaqësuesit e mjekëve shqetësohen se ky është një hap drejt "privatizimit servilosës" të spitaleve.



# KE-ja vlerëson përparimin e Kosovës dhe e inkurajon t'i normalizojë marrëdhëniet me Serbinë



**PRISHTINË, 30 TETOR** - Komisioni Evropian ka publikuar të mërkurën raportet vjetore të progresit për vendet që synojnë anëtarësimin në BE. Në dokumentin për Kosovën thuhet se autoritetet e vendit mbeten të përkushtuara në rrugën drejt integritimit evropian.

Derisa kujton se Kosova ka dorëzuar aplikimin për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2022, raporti thekson se Komisioni është i gatshëm për të përgatitur një opinion për

aplikimin e saj, kur një gjë e tillë të kërkohet nga Këshilli. Aty kujtohet se mbajtësit e pasaportave biometrike në Kosovë gëzojnë regjimin e udhëtimit pa viza drejt BE-së që nga 1 janari i këtij viti, ndërsa nga tetori të njëjtën të drejtë e kanë edhe poseduesit e pasaportave të Serbisë që ua lëshon Drejtoria Koordinuese Serbe.

Raporti thekson se tensionet në veri të Kosovës kanë vazhduar si pasojë e sulmit të dhunshëm kundër Policisë së Kosovës nga

sulmues të armatosur serbë më 24 shtator të vitit 2023.

Sulmin në Banjskë, Raporti i Progresit e cilëson si "përshkallëzimin më të rëndë në vitet e fundit". "Kriza të tjera u shkaktuan nga çështje që lidhen me shpronësimin e tokave nga qeveria në veri; nga miratimi i një rregulloreje të Bankës Qendrore për transaksionet me para të gatshme, që ndikoi negativisht te serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera joshumicë; nga operacionet

policore për mbylljen e zyrave të institucioneve të drejtuara nga Beogradi, që ofronin ndihmë për komunitetet joshumicë; dhe nga ndalimi i vazhdueshëm i importit të mallrave me origjinë serbe", thuhet në raport.

Këto çështje i dëmtuan edhe më tej marrëdhëniet ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe komunitetit serb të vendit, sipas raportit. Aty theksohet se edhe situata mes Kosovës dhe Serbisë ka mbetur e tensionuar, edhe pse ka pasur progres në

normalizimin e marrëdhënieve mes tyre. "Arritjet e dukshme përfshijnë marrëveshjet historike të dakorduara në shkurt dhe mars, 2023 [për normalizimin e marrëdhënieve], hapat përgatitorë në themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe në Kosovë, avancimet në sektorin e energjisë dhe zotimet për adresimin e çështjes së personave të pagjetur", thuhet në raport. "Kosova është zotuar se do t'i zbatojë plotësisht të gjitha detyrimet e saj përkatëse që rrjedhin nga Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit [të Marrëdhënieve me Serbinë] dhe Aneksi i Zbatimit të saj, si dhe nga të gjitha marrëveshjet e kaluara", thekson raporti.

Sipas tij, Kosova ka shënuar përparim në luftën kundër krimit të organizuar, ndërsa mjedisi i biznesit në vend është përmirësuar, po ashtu.

Në këtë dokument Kosova inkurajohet t'i shtojë përpjekjet e saj për ta forcuar sundimin e ligjit dhe administratën publike, si dhe për ta mbrojtur lirinë e shprehjes.

Aty thuhet, po ashtu, se qeveria duhet të punojë për të krijuar mbështetje politike ndërpartiake për t'i ndjekur në mënyrë më efektive reformat që lidhen me BE-në. "Kosova duhet ta zbatojë Marrëveshjen për Rrugën e Normalizimit dhe Aneksin e saj dhe të gjitha marrëveshjet e kaluara pa vonesa apo parakushte të mëtejshme", thekson Raporti i Progresit.

## BE-ja thotë se Serbia ka shkelur qartazi obligimet nga dialogu me Kosovën

**PRISHTINË, 30 TETOR** - Bashkimi Evropian ka thënë të mërkurën se Serbia i ka shkelur detyrimet e saj nga dialogu i Brukselit, duke e miratuar një projektligj për juridiksion gjyqësor serb në Kosovë dhe duke e shpallur Kosovën "zonë të mbrojtjes së veçantë sociale".

Qeveria e Serbisë njoftoi në fillim të javës se e aprovoi projektligjin për, siç e quajti ajo, organizimin dhe kompetencën e autoriteteve gjyqësore serbe në ndjekjen e veprave penale të kryera në territorin e Kosovës.

Të mërkurën zëdhënësjja e BE-së, Nabila Massralli, tha se duke bërë kështu, Serbia ka vepruar në kundërshtim me zotimet e saj në dialogun me Kosovën nën ndërmjetësimin e bllokut. "Projektligjet e Qeverisë së Serbisë, në mënyrën si janë publikuar, paraqesin shkelje të qarta nga ana e Serbisë të obligimeve nga dialogu dhe janë në kundërshtim me ripërkushtimin e shprehur

rishtazi për dialogun", tha Massralli.

BE-ja ia rikujton Serbisë se është e detyruar t'i respektojë të gjitha marrëveshjet e nga dialogu me Kosovën, të cilin është duke e zhvilluar nën ndërmjetësimin e bllokut prej vitit 2011, si pjesë e synimeve të saj për integrim evropian.

Ajo i bëri thirrje Serbisë ta rishqyrtojë këtë projektligj, i cili kërkon themelimin e një prokurorie speciale dhe një trupi gjyqësor special "për t'i ndjekur penalisht të gjithë ata që marrin pjesë në persekutimin e popullatës serbe" në Kosovë. Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, e akuzoi të martën Serbinë për shkeljen e marrëveshjeve dhe shkeljen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës me këto projektligje.

Bislimi, i cili është dhe kryenegociator në dialog, tha se Serbia "bën çdo përpjekje për ta



bllokuar" normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore. Projektligji thotë se juridiksionin në lëndët penale në shkallë të parë ta kenë Prokuroria e Lartë Publike dhe Gjykata e Lartë në Beograd, ndërsa për procedurën në shkallën e dytë Prokuroria Publike e Apelit dhe Gjykata e Apelit në Beograd, sipas qeverisë serbe. Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për gjyqësorin në vitin 2015 dhe më 2017 u pajtuan

për zbatimin e tij dhe integrimin e serbëve të Kosovës në institucionet e drejtësisë në Kosovë.

Por, qindra pjesëtarë të komunitetit serb në veri dhanë dorëheqje nga institucionet e Kosovës, përfshirë komunat, policinë, gjykatat dhe prokurorinë, në nëntor të vitit 2022, të pakënaqur me vendimet e Qeverisë së Kosovës.

Këtë vit Qeveria e Kosovës

ndërmori disa hapa - si heqja e dinarit serb nga përdorimi dhe mbyllja e strukturave paralele serbe - në përpjekje për të shtrirë sa më shumë autoritetin e saj në veri.

Kjo e shtyri Beogradin zyrtar të njoftojë në shtator se do ta krijojë Prokurorinë Speciale për territorin e Kosovës si një masë për mbrojtjen e "interesave jetike kombëtare të popullit serb" në Kosovë.

Një ditë më herët presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, kishte paraqitur një sërë masash për Kosovën, duke thënë se Prokuroria Speciale dhe dhomat gjyqësore të veçanta do t'i "ndjekin të gjithë ata që marrin pjesë në persekutimin e popullsisë serbe" në Kosovë.

Ai tha se kjo masë nuk do të zgjaste "përjetësisht", por vetëm deri në vendosjen dhe respektimin e normave të dakorduara dhe të nënshkruara në Bruksel, duke respektuar Marrëveshjen e Brukselit.



## Hasaj: Rritja e pagave, hap i duhur, por me shumë ndikime

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për rritjen e pagave nga janari i vitit të ardhshëm është hap i duhur për Blendi Hasajn, drejtor ekzekutiv në Institutin për Hulumtime të Avancuara (GAP) në Prishtinë. Ai ka përmendur argumentet ekonomike sipas të cilave është dashur të merret një vendim i tillë, por nuk e mohon faktin se kjo mund të përdoret edhe si fushatë parazgjedhore. Hasaj, gjithashtu, thekson rrezikun që sektori privat të bëhet më pak tërheqës, dhe të punësuarit në këtë sektor të ballafaqohen me paga dhe kushte më të vështira në punë

**PRISHTINË, 30 TETOR** - Vendimi i Qeverisë së Kosovës për rritjen e pagave nga janari i vitit të ardhshëm është hap i duhur për Blendi Hasajn, drejtor ekzekutiv në Institutin për Hulumtime të Avancuara (GAP) në Prishtinë. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, të martën bëri me dije se qeveria do t'i rrisë pagat në sektorin publik për 55 euro nga

janari i vitit 2025. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Hasaj përmend argumentet ekonomike sipas të cilave është dashur të merret një vendim i tillë, por nuk e mohon faktin se kjo mund të përdoret edhe si fushatë parazgjedhore. Hasaj, gjithashtu, thekson rrezikun që sektori privat të bëhet më pak tërheqës dhe të

punësuarit në këtë sektor të ballafaqohen me paga dhe kushte më të vështira në punë.

*Z. Hasaj, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se qeveria ka vendosur t'i rrisë pagat në sektorin publik nga janari i vitit të ardhshëm. Sa jeni i kënaqur me mënyrën e rritjes së pagës, rritjen e koeficientit për njësi. Kush do të përfitojë më shumë?*

**Blendi Hasaj:** Ky hap i qeverisë për rritjen e pagave, nëse e shohim nga aspekti kohor gjatë këtij viti, është ai moment kur ndryshohen pagat, pasi deri më 31 tetor ekzekutivi duhet ta dërgojë projektbuxhetin për vitin tjetër në Kuvend. Dhe është e paraparë që në Ligjin për Buxhetin të jetë edhe vlera e koeficientit të pagave. Pra, ka qenë e pritur që këto ditë qeveria ta bëjë njoftimin se a dëshiron t'i rrisë pagat në sektorin publik apo jo.

Në anën tjetër, marrë parasysh se kjo korrespondon në një periudhë që shumë shpejt do të kemi edhe zgjedhjet e përgjithshme, pastaj një interpretim tjetër mund të jetë që nuk është koha adekuatë që të rriten pagat në sektorin publik, për shkak të ndikimit që ajo mund të ketë, se si shërbyesit civilë mund të votojnë në zgjedhjet e ardhshme. Por, kemi edhe argumentin se Kosova, sikurse vendet e rajonit, por edhe në shtetet e tjera, është përballur me një normë të theksuar të inflacionit apo të rritjes së çmimeve që, vërtet, ka ndikuar në shportën e konsumatorit.

Rritjen të cilën e ka propozuar qeveria, nuk nënkupton rritje e vlerës së shumës financiare, por ndryshim i koeficienteve varësisht nga pozita. Interpretimi i parë është se qeveria dëshiron të ketë një

barazi në rritje, pra të gjithëve u rritet paga për shumën e njëjtë (55euro).

Çfarë nënkupton kjo? Nëse do të rritej vlera e koeficientit, me këtë vendim të qeverisë do të përfitonin më shumë ata punonjës në sektorin publik që kanë paga më të mëdha. Pra, nëse do të ishte rritur vlera e koeficientit, nga 110 euro, për shembull, të themi në 120 euro, normalisht se përfitimi do të ishte për ata që kanë koeficient më të lartë. Mirëpo rritja fillestare që do të bëhet për 0.5 njësi në gjashtëmujorin e parë, nënkupton një rritje uniforme për të gjithë punonjësit.

*Rritja e pagave në sektorin publik a po e bën më tërheqës këtë sektor për punëkërkuessit, dhe a ndikon kjo që ata të hezitojnë të punojnë në sektorin privat?*

**Blendi Hasaj:** Sektori që ndikon

# Kuvendi miraton Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028

PRISHTINË, 30 TETOR - Deputetët kanë miratuar të mërkurën me 59 vota Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028. Partitë opozitare nuk kanë marrë pjesë në votim, ani pse kanë shprehur kritikën e tyre. Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi ka deklaruar se ky program përbëhet nga kriteret politike, ekonomike dhe përafrimi i legjislativës. "Programi ka 306 masa, prej të cilave 105 janë masa legjislative, kurse 201 janë masa zbatuese. Nga 105 masa legjislative, 38 prej tyre projektligje,

tri janë marrëveshje ndërkombëtare, kurse pjesa tjetër janë akte nënligjore. Buxheti për zbatimin e këtij programi në përgjithësi është vlerësuar të jetë 56 milionë e 43 mijë e 856 euro, nga të cilat 22,6 milionë euro janë nga buxheti publik. Ndërkaq, 33 milionë e 434 mijë e 966 vijnë nga partnerët zhvillimorë dhe donatorët. Rrjedhimisht për implementimin e këtij programi ka zero vakum buxhetor", ka thënë Bislimi.

Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e

Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka thënë se ky dokument po tentohet të kalojë pa u debatuar. "Kur flasim për elementin politik duhet për t'ia rikujtuar zëvendëskryeministrit të parë që Kosova sot është nën sanksione. Nuk e di nëse i është dorëzuar ende raporti i progresit që në kriterin politik përfaqëson kritika të drejtpërdrejta për menaxhimin e shtetit që ka qenë në vitin e kaluar. Raporti i progresit nënvizon probleme serioze që ndërliken me kapacitetin e kësaj qeverie për ta shtyrë përpara agjendën e reformave të integritimit

evropian. Ndërlidhet, po ashtu, me një mori ligjesh të cilat bien ndesh drejtpërdrejt me kriteret e Kopenhagës, ligje të cilat kanë prekur funksionimin e institucioneve të pavarura", ka thënë Tahiri. Ndërkaq, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, deputeti Driton Hyseni ka pohuar se raportet e Bashkimit Evropian kanë evidencuar zhvillime pozitive në vend. "Meqë zotëri Tahiri përmendi që raporti dorëzohet sot, kishte qenë mirë ta presim trajtimin, ta trajtojmë me kujdes

dhe mandej të shohim se cila është perspektiva që përmban raportin, cilat janë të gjeturat e tij e ne e dimë që në dy vitet e kaluara, kemi parë që raportet e Bashkimit Evropian kanë evidencuar zhvillime shumë pozitive në vendin tonë, prandaj duhet të gëzohen pozita dhe opozita", ka deklaruar Hyseni. Të mërkurën Kuvendi ka miratuar Projektligjin për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Kosovë. Një nen i këtij projektligji u mundëson qytetarëve nga Lugina e Preshevës që të kenë pronësi mbi pronën e tyre në Kosovë.



## Kuvendi sërish dështon t'i votojë marrëveshjet ndërkombëtare

Tri marrëveshje ndërkombëtare sërish kanë dështuar të votohen në Kuvendin e Kosovës. Ato do të barten në seancat e ardhshme. "Sa po shoh, nuk ka atmosferë që të votohen. Kërkoj nga sekretaria të ketë parasysh që pikën gjashtë, siç figurojnë në rendin e ditës, pikën shtatë dhe pikën tetë, të tria marrëveshjet ndërkombëtare t'i

bartë kurdo që ka mundësi Kuvendi t'i trajtojë në ndonjë seancë të ardhshme", ka thënë Konjufca.

Kuvendi nuk arriti ta vendosë në votim marrëveshjen për "Financimin e politikave zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër", atë për anëtarësimin e

Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat e grupit të Bankës Botërore dhe marrëveshjen e kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin "Energjia diellore fotovoltaike në KEK - Porta Globale".

Kuorum nuk pati as për miratimin e

Projektligjit për Shëndetin Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar Mjekësor.

Opozita, ani pse e pranishme në sallën e seancave plenare, nuk mori pjesë në votim, ndërkaq deputetët miratuan Ligjin për Zyrarët Publikë. Për amendamentin e propozuar nga deputeti Visar Korenica kanë votuar vetëm 44 deputetë. Me 61

vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi ka emëruar shtatë anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor.

Anëtarët e këtij këshilli do të kenë mandat trevjeçar. Ata janë Artan Krasniqi, Fahri Beqiri, Besarta Reqica, Esin Salla, Zanita Halimi, Arianit Buqinca dhe Sllagjana Boshkoviç.

në rritjen ekonomike, pra punonjësit e sektorit privat, po mbesin në një anë. Derisa në sektorin publik po rritet paga mesatare në nivelet 700-750 euro, ne përballemi me një sektor privat në të cilin pagat janë më të ulëta, mirëpo edhe kushtet e punës janë më të vështira. Kjo, në aspektin ekonomik, dërgon një sinjal jo të mirë, sepse pritjet janë që ky sektor po bëhet më tërheqës për qytetarët sepse, përveç kontratës së përhershme,

sigurisë në vendin e punës, respektimin e kontratës, kanë edhe paga më të larta.

E në anën tjetër, mbi 300 mijë punonjës në sektorin privat po mbesin pa kujdesin e askujt. Kështu që, sektori publik do të bëhet edhe më tërheqës për të rinjtë. Pastaj, normalisht një ndikim tjetër është që për shkak të mundësive të kufizuara për punësim në këtë sektor dhe trajtimin jo të barabartë nga sektori privat, te disa të rinj kjo i rritë prirjet për të emigruar.

*Përveç vendimit për rritjen e pagave në sektorin publik, në fillim të këtij muaji qeveria i ka rritur edhe pensionet. A mund të ketë ndikim te votuesit, pasi në muajin shkurt janë zgjedhjet parlamentare?*

**Blendi Hasaj:** Jemi në një moment ku i kemi disa faktorë, që në një farë forme pamundësojnë të bëhet një përfundim më i saktë, që lëvizjet e qeverisë janë tërësisht politike apo janë tërësisht të argumentuara nga situata

ekonomike.

Po sikur mos të kishim, të themi, një situatë në ekonomi, ku e kemi një rritje të ndjeshme të çmimeve në dy tre vjetët e fundit, normalisht se ato kanë filluar të stabilizohen. Këtë vit nuk ka vazhduar ajo tendencë që të rriten çmimet edhe më tej, por ka mbetur ai niveli i vitit 2023.

Dhe, mos ta kishim këtë situatë dhe qeveria të ndërhyjë dhe t'i rrisë edhe pensionet edhe pagat siç po bën tani, do të ishte

vërtet një reflektim i asaj se qeveria po e bën këtë pothuajse qartazi për të ndikuar që këta qytetarë që përfitojnë, të votojnë për të. Mirëpo, duke marrë parasysh faktorët që përmenda, nuk besoj se e ka të lehtë ndonjë ekonomist apo analist i politikave ekonomike të mos e arsyetojë në këtë kohë rritjen e pensioneve, rritjen e pagave - sepse të gjithë e kemi të qartë koston që ua ka shkaktuar qytetarëve në shportën e konsumit.

# FOL-i: Institucionet e pavarura tregojnë mangësi për zbatimin e dispozitave ligjore mbi deklarimin e dhuratave

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 TETOR - Lëvizja FOL ka publikuar të mërkurën raportin "Dhuratat e pranuar nga zyrtarët e institucioneve të pavarura të Kosovës (janar - dhjetor 2023)", raport ky që ka për qëllim të sigurojë një analizë të hollësishme të dhuratave protokollare dhe të rastit të pranuar nga zyrtarët e pesë institucioneve të pavarura të Kosovës gjatë periudhës janar - dhjetor 2023.

Albana Hasani, hulumtuuese në FOL, tha se deklarimi i dhuratave dhe pasurisë është ndër mekanizmat themelorë në luftimin e korrupsionit, i cili mundëson analizimin e lëvizjeve financiare gjatë kohëzgjatjes së funksionit dhe përputhshmërinë me standardet etike dhe ligjore. Sipas Hasanit, raporti që është publikuar nga Lëvizja FOL analizon nivelin e zbatimit të dispozitave ligjore mbi pranimin e dhuratave të rastit dhe protokollare nga zyrtarët e pesë institucioneve të pavarura të Kosovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.

Institucionet e pavarura të përzgjedhura për monitorim janë Banka Qendrore e Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Dogana e Kosovës si dhe Autoriteti i Konkurrencës.

Të dhënat e paraqitura në raport janë siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike, drejtuar zyrtarëve përgjegjës të këtyre institucioneve, si dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, si institucion kyç për mbikëqyrjen e pranimit të dhuratave.

Analiza e të dhënave të paraqitura në këtë raport tregon se, ndonëse disa institucione kanë bërë përpjekje për t'i përmbyshur obligimet ligjore për raportimin e dhuratave, ekzistojnë disa mangësi të rëndësishme për implementimin e kërkesave ligjore. Gjetjet kryesore të këtij raporti janë: Zyrtarët e Bankës Qendrore të Kosovës gjatë periudhës janar - dhjetor 2023 kanë pranuar 46 dhurata, prej të cilave 18 dhurata protokollare, ndërsa 28 të rastit. Pavarësisht prej kësaj, Banka Qendrore e Kosovës nuk ka dërguar kopjen e katalogut të dhuratave të pranuar në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, obligim ky që duhet të kryhet nga institucionet deri më 31 mars të vitit vijues për vitin paraprak; Zyrtarët e Zyrës Kombëtare të Auditimit gjatë vitit 2023 kanë pranuar 11 dhurata, 7 prej të cilave janë dhurata protokollare, ndërsa 4 të rastit. Zyra Kombëtare e Auditimit është i vetmi institucion, në radhët e institucioneve të monitoruara, që ka bërë deklarim të kopjes së



katalogut të dhuratave në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2023; Zyrtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të Autoritetit të Konkurrencës gjatë periudhës së monitorimit nuk kanë pranuar asnjë dhuratë të rastit apo protokollare, ndërsa zyrtarët e Doganës së Kosovës gjatë periudhës së monitorimit kanë pranuar vetëm një dhuratë protokollare. Sipas përgjigjes së zyrtarëve të Doganës së Kosovës, kjo dhuratë është vendosur në këndin e dhuratave në Doganën e Kosovës. Megjithatë, kopja e katalogut të dhuratës së pranuar nuk është deklaruar në APK në periudhën e paraparë.

Dihet se Agjencia për

Parandalimin e Korrupsionit, në bazë të nenit 26 të Ligjit për Deklarimin e Dhuratave dhe Pasurisë, obligohet t'i inspektojë institucionet në lidhje me raportimin dhe regjistrimin e dhuratave. Ndërsa sipas të dhënave të pranuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, gjatë vitit 2023 Agjencia ka vizituar dhe inspektuar vetëm 13 institucione publike.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, Lëvizja FOL jep këto rekomandime, disa nga të cilat janë që APK-ja ta rrisë numrin e institucioneve të inspektuara përtej 13 institucioneve që janë vizituar gjatë vitit 2023. "Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e

mbikëqyrjes dhe në sigurimin që të gjitha institucionet publike t'i përbushin kërkesat ligjore për raportimin dhe regjistrimin e dhuratave. Të gjitha institucionet të dërgojnë në APK kopjet e katalogëve të dhuratave të pranuar deri më 31 mars të vitit vijues për vitin paraprak. Të vendosen mekanizma të kontrollit të brendshëm për ta monitoruar zbatimin e procedurave të deklarimit të dhuratave.

Të nxitet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të pavarura dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për shkëmbimin e informacioneve dhe praktikave të mira", është theksuar në raportin e FOL-it.

## Sveçla dhe Sarrazin diskutojnë për kontrollin e mallrave serbe në Merdar

PRISHTINË, 30 TETOR - Ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, tha të mërkurën se bisedoi me të dërguarin e posaçëm të Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, për masën e kontrolleve manuale të sigurisë për mallrat nga Serbia që hyjnë në Kosovë.

Më 7 tetor Qeveria e Kosovës e zëvendësoi vendimin për ndalimin e importit të mallrave me origjinë nga Serbia me një të ri që lejon importin, por vetëm përmes kufirit në Merdar dhe me kontroll të hollësishëm të sigurisë.

Vendimi i saj erdhi pas një trysnie të vazhdueshme nga Gjermania. "Zyrtarët tanë shtetërorë po e



zbatojnë këtë vendim me përkushtim, me qëllim të garantimit të sigurisë së vendit tonë deri në funksionalizimin e sistemeve të skanerëve 'X', që do

ta lehtësojnë edhe punën e tyre dhe pritjet në pikat kufitare", tha Sveçla në "Facebook".

Në vendkalimet e tjera u paralajmërua se do të lejohet

importi vetëm kur të sigurohen skanerët, të cilët do t'i ndihmojnë Doganës së Kosovës për kontrollin e mallrave pa ndërhyrje fizike. Ambasada gjermane tha se blerja e këtyre skanerëve është në proces, "në përputhje me të gjitha rregullat dhe rregulloret e vlefshme për prokurimin publik". Ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, tha më herët se do ta monitorojë procesin e importit të mallrave nga Serbia, pasi vendi i tij i kërkoi Kosovës heqjen e ndalesës në mënyrë që të zhblokohej CEFTA, apo Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore, dhe të përparonte Procesi i Berlinit - një nismë kjo që synon ta ndihmojë

zhvillimin ekonomik të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe afrimin e tyre me Bashkimin Evropian.

Sveçla tha se e falënderoi Sarrazin për "angazhimin e vazhdueshëm për avancimin e bashkëpunimit rajonal". "Diskutua për ecurinë e takimit të fundit të Procesit të Berlinit dhe rikonfirmova përkushtimin tonë si palë aktive për angazhim të mëtejshëm në kuadër të këtij procesi", tha ai.

Përndryshe, Kosova thekson se vendimi për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia, në mes të korrikut të vitit 2023, u mor për "arsye sigurie", pas arrestimit të tre policëve të Kosovës nga policia serbe.

## Kryeqyteti vendos standarde të reja për sigurinë në trafik nëpërmjet digjitalizimit të gjobave

PRISHTINË, 30 TETOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama dhe Policia e Kosovës kanë marrë një hap të rëndësishëm për sigurinë rrugore, lidhur me digjitalizimin e gjobave të trafikut. Pikat kyçe përfshijnë monitorimin dhe menaxhimin e trafikut me pajisje moderne dhe

digjitalizimin e të dhënave, njoftimin e kundërvajtësve përmes adresave elektronike të pronarëve të mjetit (telefon, e-Kosova) dhe dërgimin e gjobave në adresën e pronarit të automjetit përmes Postës së Kosovës.

Kryetari Rama ka thënë se me këtë kryeqyteti vendos

standarde të reja për sigurinë në trafik përmes digjitalizimit të gjobave. "Kjo marrëveshje përfshin përdorimin e pajisjeve të avancuara që mund t'i monitorojnë automjetet në kohë reale dhe përdorimin e teknologjisë për ta përmirësuar trafikun", ka thënë Rama.



# Haxhiu kërkon hetim urgjent për mbylljen e dyshimtë të rastit të pronës milionëshe në Veternik

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 TETOR - Ministrija e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se është e shqetësuar pasi Prokuroria Speciale ka mbyllur hetimet për rastin e pronës milionëshe në Veternik, e cila pronë dyshohet se u fitua përmes mashtrimit dhe falsifikimit të dokumenteve, bazuar në një zarf të ardhur përmes postës "DHL Serbia".

Ministria Haxhiu thotë se me këtë rast dëshmohej se si funksionon drejtësia në Kosovë dhe se në mënyrë të falsifikuar i merret prona qytetarit dhe në mënyrë të falsifikuar nga Serbia, po ashtu, mbyllet rasti në dëm të qytetarit. "Rasti me tokën në lagjen 'Veternik' të Prishtinës dhe kjo që ndodhi me zarfin që, sipas raportimeve nga 'Betimi për drejtësi' dhe 'Tempus', del të jetë dokument i falsifikuar nga Beogradi, me të cilin dokument Prokuroria Speciale mbylli hetimet. Është vërtet shembull se si ka funksionuar e funksionon ende drejtësia në Republikën e Kosovës. Pra, në mënyrë të falsifikuar i merret prona qytetarit dhe në mënyrë të falsifikuar nga Serbia, po ashtu, mbyllet rasti në dëm të qytetarit. Që moti si subjekt politik në Kuvend kemi folur për drejtësinë e kapur dhe nevojën për vetting si të vetmen mundësi për të dalë nga ky qark i mbyllur", ka shkuar Haxhiu në "Facebook".

Ajo ka thënë se që prej marrjes së mandatit pa reshtur ka punuar



për përgatitjen e dokumenteve që do ta fillonin procesin e vettingut, prej të cilit proces do të pastrohej vetë sistemi i drejtësisë e do të rikthehej kredibiliteti e besueshmëria në këtë pushtet mjaft të rëndësishëm për republikën. "Mirëpo ka pasur një siklet dhe rezistencë nga qarqe të ndryshme, sa në politikë, sa në drejtësi ndaj këtij procesi, ndërkaq kemi parë për këto katër vjet qeverisje se si qindra lëndë janë dorëzuar vetëm nga kabineti qeveritar me afera nga kohët e kaluara për të cilat në asnjë rast të vetëm nuk kemi parë të jetë ndërmarrë diçka nga

ana e Prokurorisë Speciale. Në anën tjetër kemi parë që ndaj qeverisë, ministrave e zyrtarëve të subjektit prej nga jemi, ka pasur reagime dhe impulse nga ana e kësaj prokurorie, madje edhe për statuse 'Facebook'-u se lëre më diçka më shumë", ka thënë Haxhiu.

Ajo ka shtuar se sa i përket rastit të tokës në Prishtinë e cila, siç pretendohet, i është marrë familjes përmes falsifikimit të dokumenteve, fillimisht ka pasur ndjekje penale për disa persona. "Por, çështja ka vazhduar edhe më tutje, kur aty kanë vazhduar punimet, pavarësisht rastit në

gjykatë. Familja ka paraqitur disa fakte të lidhjes së vet të arrestuarve e të përndjekurve në këtë rast me vetë familjen e kryeprokurorit aktual të Speciales. Në vazhden e zbardhjes së këtij rasti, si Ministri e Drejtësisë, në kuadër të kompetencave tona ligjore, kemi dërguar letër në organet kompetente në Serbi për të marrë përgjigje në lidhje me të vërtetën e pronës, por asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje siç nuk marrim kurrë për shkak të problemeve politike. E javën e kaluar në media u publikua se rasti është mbyllur për këtë

çështje nga Prokuroria Speciale pas një zarfi që, kinse, paska ardhur nga Serbia në Kosovë, ku jepet përgjigja për të vërtetën e provës. Ndërkaq, mbrëmë, siç u raportua, u mohuan se nga institucionet atje është dërguar kjo letër, çka e bën edhe më inkriminuese situatën dhe nxit dyshime se është përfshirë vetë Prokuroria Speciale", ka thënë ajo, duke shtuar se Danilo Radunović, përgjegjës i Departamentit të Arkivave të Entit Republikan i Gjeodezisë në Serbi, ka thënë se ata nuk kanë asnjë lidhje me këtë dërgesë, thuhet në publikimin e djeshëm. "Si ministre e Drejtësisë jam vërtet e shqetësuar me këtë rast dhe me pretendimet e përfshirjes dhe të aktorëve institucionalë të drejtësisë në këtë rast të kësaj prone, që nga vetë prona deri te mbyllja e rastit me dokumente të falsifikuara. Autoriteti përgjegjës me urgjencë duhet ta hetojë mbylljen e dyshimtë të këtij rasti nga Prokuroria Speciale përmes dokumenteve të falsifikuara dhe t'i trajtojë, po ashtu, shqetësimet e faktura të familjes së dëmtuar për lidhjet në këtë rast të vet prokurorëve specialë të Kosovës me pronën konkrete. Drejtësia ka kuptim veç kur e mbron të dobët nga i forti e i pushtetshmi. Kur i pushtetshmi lidhet me krimin, aty krimi bëhet i organizuar dhe institucional. Aty bie edhe drejtësia, demokracia e republika. Dhe kjo nuk duhet të tolerohet", ka deklaruar Haxhiu.

## Përfundon procedura e punësimit për mjekë të profileve të ndryshme dhe për infermierë

EPOKA  
ERE

Qendres RAMA

PRISHTINË, 30 TETOR - Është mbajtur mbledhja e gjashtëdhjetë e Bordit Drejtues të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës. Mbledhjen e hapi dr. Dren Boshnjaku, kryesues i Bordit, i cili fillimisht njoftoi anëtarët me rendin e ditës dhe mundësinë e propozimit për pikat e ndryshme në kuadër të diskutimeve.

Më pas kryesuesi i dha fjalën drejtorit të përgjithshëm të ShSKUK-së, Elvir Azizi, i cili paraqiti disa nga punët që janë zhvilluar kohën e fundit në ShSKUK. Fillimisht ai njoftoi se ka përfunduar procedura e punësimit për mjekë të profileve të ndryshme dhe për infermierë të cilët, pas një analize të brendshme, janë shpërndarë në klinika të ndryshme, por edhe në spitalet e përgjithshme. Ai foli se ShSKUK ka në proces të licencimit shërbimin e

dozimetrisë në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë e që, pas licencimit, dozimetrat do të mbikëqyren nga ky institucion.

Në pikat e ndryshme të rendit të ditës anëtarët e Bordit Drejtues u interesuan për pozitën që janë me ushtrues detyrë si do të veprohet, po ashtu për punësim të mjekëve të papunësuar në spitalet e përgjithshme.

Drejtori Azizi i njoftoi anëtarët e Bordit se ka filluar përgatitja e konkurseve për pozitën me ushtrues detyrë dhe me sa është informuar nga u. d. drejtori i QKUK-së, konkursi po përgatitet dhe do të procedohet shpejt.

Sa i përket punësimit të mjekëve specialistë në spitalet e përgjithshme, drejtori i ShSKUK-së sqaroi se kanë pranuar kërkesat nga të gjitha njësitë dhe drejtori shëndetësor është në fazën e analizës, ato do të procedohen shpejt aty ku vlerësohet e nevojshme dhe lejohet mundësitë.



## INDEP: Koeficientet të harmonizohen me pagën minimale, jo me lojërat e partive për pushtet

PRISHTINË, 30 TETOR - Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka shprehur shqetësimin e thellë që, për të disatën herë, partitë politike në Kosovë po përdorin ndryshimet në nivelet e pagave të sektorit publik për qëllime elektorale. "Vendimi i fundit i qeverisë për rritjen graduale të koeficienteve të pagave në sektorin publik dhe reagimet e ngjashme nga opozita janë shembull tjetër i kësaj prirjeje shqetësuese, veçanërisht në kohën kur vendi po i afrohet zgjedhjeve të reja", ka vlerësuar INDEP.

Më tej theksohet se në kohën e diskutimit dhe miratimit të Ligjit për Pagat, INDEP kishte argumentuar se koeficientet duhet të ndërlihdhen drejtpërdrejt me vlerën e pagës minimale. "Ky model jo vetëm që do të ofronte transparencë dhe një bazë të qëndrueshme, por edhe do të siguronte një lidhje të domosdoshme në mes të sektorit publik dhe atij privat. Procesi për përcaktimin e pagës minimale, i cili është rezultat i propozimit nga

Këshilli Ekonomiko-Social - organ ku përfaqësohen partnerët socialë, përfshirë përfaqësuesit e sektorit privat (odat ekonomike, sindikatat dhe qeveria) - është gjithëpërfshirës dhe reflekton një qasje të balancuar që garanton respektim të interesave të të gjitha palëve. Rritja e njëanshme e pagave në sektorin publik pa një ndërlihdje direkte me sektorin privat shkakton jo vetëm ndasi ekonomike, por ndikon në të gjithë ekuilibrin ekonomik të vendit. Këto ndryshime duhet të jenë rezultat i rritjes ekonomike të përgjithshme dhe të vendimmarrjes së përbashkët sociale, e jo premtimeve a vendimeve në prag të zgjedhjeve", thuhet në reagimin e INDEP, duke theksuar se praktikata e përsëritura të partive politike për t'i manipuluar pagat publike gjatë cikleve zgjedhore janë precedent i dëmshëm që minon integritetin e politikave publike dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. "INDEP apelon që rritjet e koeficienteve të pagave të jenë produkt i një metodologjie të qartë,



transparente dhe të parashikueshme, të mbështetur në indikatorë ekonomikë të mirëfilltë dhe në një qasje të konsultuar me të gjitha palët. Manovrat politike, që synojnë ta shfrytëzojnë ndjeshmërinë e qytetarëve ndaj kushteve ekonomike për përfitime elektorale, e largojnë fokusin nga

politikat afatgjatë dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Rritja e inflacionit dhe përkeqësimi i kushteve të jetesës për qytetarët kërkon një qasje të përbashkët, ku interesi publik dhe mirëqenia ekonomike e të gjithë qytetarëve janë mbi interesat partiake. Për një sistem pagash më të drejtë dhe të

qëndrueshëm, INDEP edhe njëherë bënë thirrje për harmonizimin e koeficienteve me pagën minimale dhe për një politikë që bazohet në ligjënie gjithëpërfshirëse, larg premtimeve të brishta dhe politizimit elektorale", theksohet në reagimin e INDEP-së.

## Krijimi i Fondit të Inovacionit të Kosovës hap rrugën për një ekosistem inovativ në vend

EPOKA  
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 30 TETOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në bashkëpunim me projektin EnInGeP, ka organizuar ngjarjen "Krijimi i Fondit të Inovacionit të Kosovës: prezantimi i gjetjeve fillestare dhe hapat e ardhshëm". Në këtë ngjarje të rëndësishme morën pjesë përfaqësues të lartë të qeverisë, ambasadave, sektorit privat dhe akademisë, duke krijuar një platformë të pasur për të diskutuar të ardhmen e inovacionit dhe ndërmarrësisë në Kosovë.

Gjatë ngjarjes u paraqit udhërrëfyesi më i hollësishtëm i hartuar ndonjëherë në fushën e inovacionit për Kosovën, i cili është, gjithashtu, hapi i parë konkret drejt themelimit të Fondit të Inovacionit të Kosovës. Ky dokument shpjegon se si pritet të funksionojë fondi si dhe qëllimet e tij kryesore për të mbështetur dhe fuqizuar ekosistemin e inovacionit në vend.

Ky udhërrëfyes thekson ndërtimin e një fondi të qëndrueshëm që do



të sjellë përfitime të drejtpërdrejta për inovacionin dhe ndërmarrësinë, duke krijuar një strukturë të mirëfilltë për mbështetjen e bizneseve, projekteve kërkimore dhe sektorëve të rëndësishëm ekonomikë në vend. Fondi synon të jetë një mekanizëm strategjik

dhe gjithëpërfshirës që do të ofrojë ndikim afatgjatë dhe përfitime të prekshme për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Ngjarja përfshiu një panel diskutimi të drejtuar nga Kujtim Dobruna, partner menaxhues i ECIKS dhe ekspert i EnInGeP për Fondin e Inovacionit, i cili solli

bashkë ekspertë nga fushat e inovacionit, akademisë dhe bankave.

Diskutimi u përqendrua shkëmbimin e përvojave nga Austria, me synim të sigurimit të jetëgjatësisë dhe ndikimit të mirëfilltë në ekonominë dhe ekosistemin e inovacionit në

Kosovë. Ministria e MINT, Rozeta Hajdari, e cila hapi ngjarjen, theksoi rëndësinë e këtij fondi në mbështetjen e zhvillimit teknologjik dhe ekonomik, duke vlerësuar projektin si një gur themel për të ardhmen e qëndrueshme të vendit. "Fondi për inovacion është vendosur në Agjencinë KIESA dhe do të fillojë të funksionojë sapo të aprovohet rregullorja relevante. Duke filluar me fuqizimin e startupeve dhe NMV-ve, ne do ta përkrahim rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve kosovare në përgjithësi", ka theksuar Hajdari. Ky hap shënon një moment të rëndësishëm për të ardhmen e inovacionit në Kosovë, duke krijuar bazat për një mbështetje të qëndrueshme që do të ndikojë në zhvillimin e inovacionit dhe ndërmarrësisë në përgjithësi në vendin tonë.

Projekti EnInGeP - Enabling Income Generation for the Poor, financohet nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim dhe zbatohet së bashku nga CARE International dhe ECIKS.

## Murati: Pagat janë rritur në vitin 2023, 2024, do të rriten edhe në vitin 2025

PRISHTINË, 30 TETOR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka theksuar se pagat në sektorin publik janë rritur në vitin 2023, janë rritur në vitin 2024, dhe tani po rriten edhe

në vitin 2025. "Pra rritje për tri vite radhazi që prej hyrjes në fuqi të ligjit të pagave, ashtu siç do duhej, krahas rritjes ekonomike. Rritja do të jetë 110 euro në muaj për secilin

punonjës të sektorit publik. Hyrja në fuqi e rritjes do të jetë e ndarë në dy faza - ku faza e parë prej janarit pagat rriten për 55 euro, ndërsa faza e dytë prej korrikut ku rritja bëhet 110 euro",

ka shkruar Murati në "Facebook". Ai ka thënë se pagat rriten për të gjithë shërbyesit publikë e jo vetëm për pozitën që i ka shfaqur në tabelë gjatë konferencës.





# 1 javë nga zgjedhjet, çfarë thonë sondazhet në shtetet kyçe?

Garë kokë më kokë mes Harris dhe Trump. Kandidatja demokrate është pak përpara në Michigan, kandidati republikan në shtetet e tjera përveç Wisconsin, ku janë në barazi të plotë. New York Times: Ekipi i Kamala është pak optimist.

## Rezultatet në nivel kombëtar

Do të jetë një sfidë për votën e fundit, veçanërisht në shtatë shtetet kyçe (Arizona, Georgia, Michigan, Nevada, Karolina e Veriut, Pensilvania dhe Wisconsin) që do të vendosë se kush, midis kandidatës demokrate Kamala Harris dhe kandidatit republikan Donald Trump, do të shkojë në Shtëpinë e Bardhë për mandatin e ardhshëm si president.

Një javë para ditës së madhe, sondazhet zbulojnë një situatë kokë më kokë në secilën nga shtatë shtetet vendimtare. Nisur nga projeksionet në nivel kombëtar, Harris është përpara me 48.1% kundrejt 46.6% të Trump. Më tej, 5.3% mbeten të pavendosur. Por këto të dhëna llogariten pak ose aspak, sepse me sistemin zgjedhor amerikan – çdo shtet cakton një numër “zgjedhësish të mëdhenj” në



përfaqësues me madhësinë e tij demografike – beteja do të copëtohet deri në nivel qarqesh.

## Shtatë vendimtare

Prandaj, më indikative janë sondazhet e shteteve kyçe. Sipas të dhënave ditore që faqja e internetit FiveThirtyEight përpunon bazuar në gjetjet e fundit, Harris mendohet se ka një avantazh të vogël (+0.5%) në Michigan ndërsa Trump e ka në Pensilvani (+0.3%) dhe Nevada

(+0.2%). Megjithatë, diferenca është pak më e theksuar, përsëri për kandidatin republikan, në Arizona (+1.90%), Georgia (+1.50%) dhe Karolinën e Veriut (+1.30%). Barazim plotë në Wisconsin. Vetëkuptohet se me distanca kaq të ngushta dhe me të panjohurat e pjesëmarrjes, të votës së pavendosur dhe të surprizave të mundshme e të paparashikueshme në këto ditë të fundit të fushatës elektorale, rezultati mund të jetë padyshim ndryshe nga sa pritet.

Një shembull? Deklaratat raciste të komedianit pro Trump Tony Hinchcliffe të dielën në mbrëmje në skenën e Madison Square Garden (“Ka një ishull lundrues mbeturinash në mes të oqeanit. Unë mendoj se quhet Puerto Rico”) nuk do t’i pëlqejnë komunitetit portorikan, i cili, veçanërisht në Pensilvani, është i shumtë në numër. Në një shtet që katër vjet më parë u fitua nga demokratët me vetëm 82,000 vota (1.12%), nëse vetëm disa mijëra njerëz do të vendosnin të

shkonin dhe të votonin apo edhe të ndryshonin zgjedhjen e tyre në minutën e fundit në favor të Harris, mund të rezultojnë vendimtare.

## Optimizëm i moderuar

Edhe strategjia e përqendrimit të vota e femrave dhe ngjyrosja e Trumpit si “fashist” për frazazet e tij mbi besnikërinë e gjeneralëve të Hitlerit, sipas strategëve, po funksionon. Sipas asaj që zbulon New York Times, spin doktorët në ekipin e Harris janë mesatarisht optimistë për arrijtjen e një fitoreje, ndonëse të ngushtë, falë treguesve nga sondazhet e tyre të brendshme se kandidatja është në një pozicion solid në shtetet e “blue wal” (muri blu, ose 18 shtetet që demokratët i kanë fituar gjithmonë në çdo zgjedhje që nga viti 1992, përveç vitit 2016 kur Trump fitoi Michiganin, Pensilvaninë dhe Wisconsinin). Edhe në ekipin e Trump ka optimizëm se mund të pushtojë të paktën një shtet të “muri blu”, por – zbulon gjithmonë gazeta e Nju Jorkut – ka edhe pak shqetësim pikërisht për këtë “reductio ad Hitlerum” që mund të lëvizë votat vendimtare të të moderuarve. /bota.al

# Manifesti Komunist, dokumenti që frymëzoi revolucionet në mbarë globin

Manifesti Komunist ishte një pamflet politik i botuar në Londër nga Lidhja Komuniste (një grup socialistësh revolucionarë me origjinë gjermane) në shkurt të vitit 1848. Duke pasur parasysh ambicet e tij madhështore, ai kishte një hapje dramatike, të denjë për ambicet e atyre që e kishin hartuar: “Një hije po bie mbi Evropë – hija e komunizmit.” Manifesti ishte një zhvillim i përbashkët i ideve të Karl Marksit dhe Friedrich Engels-it, por drafti përfundimtar u shkrua vetëm nga Marks në janar 1848 në Bruksel. Ai ndoqi një shabllon që Engelsi kishte shkruar më parë për Lidhjen e të Drejtëve (Marksit dhe Engelsit iu kërkua t’i bashkoheshin, dhe ata e riemërtuan Lidhja Komuniste). Teksti i Manifestit u bë një material me ndikim politikisht të rëndësishëm në publikun gjerman dhe bëri që Marks të dëbohej nga vendi.

Megjithëse shumë nga idetë në Manifestin Komunist nuk ishin të reja, vepra u dërgua në Londër dhe u miratua nga Lidhja si manifesti i grupit. Ai argumentonte se shfrytëzimi i një klase nga një tjetër është forca motivuese pas çdo zhvillimi në

histori. Në botim, Marks i parashikoi një revolucion të afërt në Evropë dhe menjëherë pas daljes të tij, shpërtheu vërtet revolucioni në Francë, për ndalimin e takimeve politike që mbaheshin nga opozita dhe grupet socialiste.

Mbreti Louis Philippe I u detyrua të abdikonte pas trazirave të izoluar që çuan në revoltë popullore dhe nuk kaloi shumë kohë përpara se revolucioni të përhapej në të gjithë Evropën. Marks, i cili ishte në Paris në atë kohë, u dëbua nga qeveria belge, e cila kishte frikë se edhe Belgjika do të përfshihej shpejt nga revolucioni.


Pavarësisht se botimi original në gjermanisht pati pak ndikim të menjëhershëm, idetë e tij jehuan në shekullin e ardhshëm dhe në vitet 1950 pothuajse gjysma e popullsisë së botës jetonte nën sundimin marksist. Manifesti do të shërbente si një thirrje politike për lëvizjen komuniste në të gjithë Evropën.

I shkruar në katër pjesë, dokumenti fillon duke vënë në dukje se borgjezia evropiane e kishte identifikuar komunizmin si një kërcënim, për shkak të potencialit të tij për të ndryshuar

sistemin ekonomik dhe strukturën e pushtetit të njohur si kapitalizëm.

Pjesa e parë e dokumentit shpjegon evolucionin e kapitalizmit dhe strukturën klasore që ai krijoi; një sistem i ri klasor i përbërë nga punëtorët me paga (proletariati) dhe pronarët e mjeteve të prodhimit (borgjezia). Marks dhe Engelsi theksuan se botëkuptimet dhe interesat e pakicës së fuqishme dhe të pasur pasqyrohen nga shteti dhe jo nga pikëpamjet e proletariatit, i cili përbën shumicën e shoqërisë. Ata vazhduan të diskutojnë realitetin shfrytëzues me të cilin përballen punëtorët e detyruar të konkurrojnë për punë dhe t’ia shesin punën e tyre borgjezisë. Sipas tyre, punëtorët shpejt bëhen të shpenzueshëm pasi zëvendësohen kollaj. Megjithatë, autorët e Manifestit e kuptuan të metën në këtë qasje: “Ajo që prodhon borgjezia, mbi të gjitha, janë varmihësit e saj. Rënia e tij [sistemit] dhe fitorja e proletariatit janë po aq të pashmangshme”.

Lëvizja komuniste u përpoq të përfaqësonte interesat e proletariatit dhe synonte të bashkonte punëtorët në një klasë me të njëjtat interesa dhe të




rishtëpërdante pushtetin politik duke përmbytur sundimin e borgjezisë. Marks dhe Engelsi përcaktuan dhjetë synime që ata shpresonin t’i zbatonin, duke përfshirë eliminimin e pronës private dhe futjen e arsimit falas për të gjithë fëmijët në shkollat publike.

Pjesa e tretë përqendrohet në një vizion të asaj që mund të ishte, me një qëllim përfundimtar krijimin e shoqërive të reja dhe jo reformimin e atyre ekzistuese, një ëndërr që do të arrihej përmes një lufte kolektive nga proletariati. Pjesa e katërt dhe e fundit shpreh mbështetjen për të gjitha lëvizjet revolucionare që sfidonin rendet ekzistuese politike dhe shoqërore

të kohës.

Duke thirrur klasën punëtore të qëndronte si një e vetme, Marks i mbyll me një thirrje për armë: “Proletarët nuk kanë asgjë për të humbur përveç zinxhirëve të tyre. Ata kanë një botë për të fituar. Punëtorët të botës, bashkohuni!”

Që nga fundi i shekullit të 19-të, Manifesti Komunist (i cili është rishikuar dhe ribotuar shumë herë) është lexuar gjerësisht në mbarë botën dhe mbetet themeli për kritikët e kapitalizmit. Ai ka dëshmuar të jetë frymëzim për shumë sisteme ekonomike, sociale dhe politike që tani organizohen nga demokracia dhe barazia dhe jo nga shfrytëzimi i masave. /bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Presidenti Saraçini uron hendbollistet për suksesin e madh, pret rezultatet edhe nga hendbollistet

PRISHTINË, 30 TETOR - Presidenti i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini, i ka përkrahur nga afër hendbollistet e Kombëtares së Kosovës që fundjavën e kaluar shkëlqyen në Hasselt të Belgjikës. Vashat "dardane" fituan ndaj Belgjikës dhe Bosnjë-Hercegovinës dhe u kualifikuan në raundin e dytë kualifikues të Botërorit 2025.

Presidenti Saraçini ka vlerësuar lart suksesin e arritur nga hendbollistet, ndërsa është kujdesur që vajzat dhe shtabi teknik ta kenë përkrahjen e duhur dhe kushtet optimale gjatë grumbullimit në Belgjikë. Gjatë bashkëbisedimeve të vazhdueshme me hendbollistet dhe trajnerët, presidenti Saraçini është bindur për përkushtimin e

të gjithë të përfshirëve për ngritjen e mëtejme të nivelit të Kombëtares. Pas ndeshjes me Bosnjë-Hercegovinën, presidenti Eugen Saraçini ka uruar Kombëtaren, duke premtuar se përkrahja ndaj saj do të jetë edhe më e madhe, me synimin e qartë për kualifikim në Botëror. "Ndërkohë presidenti Saraçini i uron sukses maksimal edhe

kombëtares së hendbollistëve që grumbullohet të hënën për ndeshjet e para të fazës së fundit kualifikuese për Kampionatin Evropian 2026. I pari i shtëpisë kosovare të hendbollit është i bindur se hendbollistet tanë do ta japim maksimumin dhe do të luftojnë pa kompromis për fanellën e shtetit tonë", thuhet në njoftimin e FFK-së.



## Dy ndeshjet e Superligës përfundojnë pa fitues, sot derbi Drita - Prishtina

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 TETOR - Dukagjini dhe Suhareka janë ndarë baras 2-2 në një ndeshje spektakolare në kuadër të xhiros së 11-të në Albi Mall Superligën e Kosovës në futboll. Në minutën e 24-t mysafirët kaluan në epërsi me golin e shënuar nga Mevlan Zeka, i cili me kokë realizoi për 0-1. Vendasit reagon pas dy minutash duke e barazuar rezultatin në 1-1, me golin e shënuar nga Hekuran Berisha. Nëntë minuta pas fillimit të pjesës së dytë, Suhareka e riktheu epërsinë në 1-2 me golin e shënuar nga Liridon Fetahaj. Suhareka mbeti me 10 futbollistë në fushë, kur në minutën e 68 Jakup Berisha u ndëshkua me kartonin e dytë të verdhë dhe u përjashtua nga loja. Vetëm katër minuta më vonë, Dukagjini e barazoi rezultatin në 2-2, sërish



shënues ishte Hekuran Berisha. Dukagjini me këtë pikë vazhdon të mbesë në pozitën e nëntë me 11 pikë, derisa Suhareka në të tretën me 17 sosh. Edhe ndeshja tjetër në mes të Llapit dhe Feronikelit '74 përfundoi me rezultat 2-2. "Nikli" ishte afër ta shijojë fitoren e parë, por vendasit barazuan në minutat shtesë për të shpëtuar nga humbja. Në

pjesën e parë vendasit luajtën më mirë, por mysafirët shënuan golin e parë në ndeshje. Në minutën e 45-t Vasilis Karagounis shënoi një gol të bukur për 0-1. Në minutën e 68 Hasan Hyseni realizoi për 0-2. Tetë minuta pa përfunduar koha e rregullt, Ardit Tahiri e ngushtoi epërsinë në 1-2, derisa kur të gjithë priten fitoren e mysafirëve në skenë doli Ilir

Blakçori, i cili në minutën e shtatë shtesë shënoi për rezultatin përfundimtar 2-2. Pas këtij barazimi, Feronikeli mbetet i fundit me vetëm tri pikë, ndërsa Llapi zë vendin e gjashtë me 15 pikë. Sot (e enjte) zhvillohen dy

ndeshjet e fundit për këtë xhiro, derisa vëmendja do të jetë në derbin në mes të Dritës dhe Prishtinës. Ndërkohë në ndeshjen tjetër përballen Ferizaj dhe Malisheva. Të dy ndeshjet zhvillohen nga ora 13:00.

### Ramadani: Ndaj Prishtinës synojmë tri pikët

Të enjten zhvillohet derbi i madh në mes të Dritës dhe Prishtinës. Trajneri i Dritës, Zekirija Ramadani, ka thënë kryeqytetasit janë emër i madh në futbollin e Kosovës dhe ndeshje të tilla gjithmonë prodhojnë derbi. "E kemi një derbi, ndaj një skuadre që si ne gjithmonë synon kreun e tabelës-titullin kampion. Duhet të mendojmë edhe për ekipin tonë, sepse kemi tri barazime radhazi dhe është momenti i

duhur për të reflektuar ekipi, për të qenë më agresiv për të ardhur deri tek objektivi i ndeshjes trepikëshi", ka thënë Ramadani.

#### SUPERLIGA

Dukagjini - Suhareka	2-2
Llapi - Feronikeli 74	2-2
Ballkani-Gjilani	3-3

Të enjten takohen:  
Drita - Prishtina  
Ferizaj - Malisheva

## Vendoset gurthemeli i stadiumit të ri të KF Kika në 50-vjetorin e klubit

KAMENICË, 30 TETOR - Në 50-vjetorin e KF Kika në Hogosht është hedhur gurthemeli i stadiumit të ri, i cili do ta zëvendësojë fushën me një histori 50-vjeçare dhe e cila kishte një rëndësi të madhe në zhvillimin e futbollit të Kosovës gjatë viteve '90 të rezistencës ndaj pushtuesit serb. Tani në vend Kodrës së Livadhit të Latifit, siç njihet në këtë anë, do të jetë një stadium me një

tribunë moderne dhe që do të ofrojë kushte të shkëlqyeshme si për KF Kika, po ashtu edhe për komunitetin e futbollit të kësaj treve. Ky projekt i rëndësishëm është një bashkëpunim në mes të Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Federatës së Futbollit të Kosovës dhe komunës së Kamenicës.

Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, shprehu kënaqësinë e tij



në ceremoninë e vendosjes së gurthemelit: "Uroj që ky

impianit të shërbejë për KF Kika dhe të gjitha klubet e tjera të rrethinës që gravitojnë këtu. I uroj themeluesit e klubit, Nazif Kastratin, sidomos Bajram Vrajën, ish-kryetarin e klubit, për kontributin e tyre të çmuar në periudhën më të vështirë të futbollit kosovar. Po ashtu, falënderoj kryetarin aktual Naim Biçkaj për përkushtimin e tij në ndërtimin e këtij impianit të rëndësishëm për zhvillimin e

futbollit në rajon". Krahas presidentit Ademi në këtë ceremoni morën pjesë edhe anëtari i KE të FFK-së, Naser Ajeti, legjenda e futbollit e kësaj ane, Muharrem Sahiti dhe kryetari i LRF të Gjilanit, Armend Misini, si dhe zyrtarë të MKRS-së dhe të komunës. I pranishëm ishte edhe tifozë më i vjetër i klubit, 92-vjeçari Aga Dan, i njohur për pasionin e tij të palëkundur për futbollin.

### Xhudoja në shkolla po rritet

PRISHTINË, 30 TETOR - Po vazhdojnë seksionet e xhudos në shkolla të komunave të ndryshme të Kosovës. Kësaj radhe po ndajmë disa çaste nga ushtrimet që po mbahen me rotacion në ShFMU

"Dardania" në Pejë. Në këtë shkollë trajneri i xhudos Loris Sharapolli bashkë me nxënësit po i mësojnë vlerat e xhudos si miqësia, nderi, respekti në një atmosferë e energji të shëndoshë.

Seksionet mbahen një herë në javë me nxënësit e klasave të ciklit të ulët 1 deri 5. Programi shtetëror, "Kosova, shtet i xhudos", përmes komponentit, "Xhudo në shkollat xhudistët e rinj", ka për qëllim ta

zhvillojë masivizimin dhe integrimin e disiplinës së xhudos në të gjitha shkollat dhe komunat e Kosovës. Ky program mbështetet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.



## Dorëzohen te Mercedesi: Po punojmë për vitin 2025

**SHTUTTGART, 30 TETOR** - Pas serisë prej tri fitoresh të arritura në katër garat e fundit para pushimit veror, Mercedesi u është rikthyer garave anonime në këtë fazë të fundit të sezonit. Pas pushimeve verore, Lewis Hamilton dhe George Russell kanë arritur vetëm një podium,

atë në Baku. Duket qartë se Mercedesi nuk është më në gjendje të rivalizojë me Ferrarin dhe McLarenin, të vetmet që kanë triumfuar në garat e fundit të Formulës 1. Drejtori sportiv i Mercedesit, Toto Wolff, nuk pret fitore as në pistën e Interlagos në Brazil, ku garohet

këtë fundjavë. "Duke pasur parasysh pozicionin tonë në kampionat, ne ishim në gjendje të testonim gjërat duke paguar një çmim. Jemi ende të fokusuar për t'i maksimizuar rezultatet tona. Çdo fundjavë përgatitemi më mirë për vitin 2025. Ne do të vazhdojmë ta

ndjekim këtë qasje edhe në Brazil", ka thënë Wolff. "Interlagos është një circuit për pilotë të vërtetë, ka shumë valëzime dhe një përzierje sfiduese të shpejtësisë së kthesave të ulëta, mesatare dhe të larta. Ne e dimë se do të jetë e vështirë të sfidojmë Ferrari



dhe McLaren, të cilët janë shfaqur të fortë në garat e fundit", ka shtuar Wolff.

# Conte: Napoli lufton për titull në Serinë A

**NAPOLI, 30 TETOR** - Antonio Conte pranon se Napoli po lufton për titullin e kampionit në Itali këtë sezon, sidomos pas fitores në "San Siro" me rezultat 2-0. "Partenopei" vazhdoi ecurinë e tyre të jashtëzakonshme të formës, duke fituar nëntë nga 10 ndeshjet e fundit. Më e rëndësishmja, pësoi vetëm dy gola në atë seri dhe shënoi 23 mes Serisë A dhe Coppa Italia. Duke marrë parasysh se është larguar në krye të tabelës dhe ka përfitim të shtuar të mungesës së angazhimeve evropiane në mesjavë, Conte pranoi se Napoli nuk do të fshihet nga ajo se lufton për titull. "Askush nuk fshihet këtu. Thjesht shikojmë realisht atë që po bëjmë këtë vit, e cila pas 10 raundeve është, për mendimin tim, e pabesueshme dhe as ëndrra më e çmendur nuk mund ta kishte parë këtë", ka thënë Conte për "DAZN". "Duhet t'i



marrim ndeshjet një nga një. E di që emri dhe karriera ime do të thotë që më jepet përgjegjësi që në fillim sepse kam arritur disa gjëra. Çdo klub që fillon sezonin e di objektivin e tij, ne e dimë tonën dhe ai ishte rikthimi në Evropë,

sepse Napoli ishte jashtë për herë të parë në 14 vjet. Nëse mund të hyjmë nga dera e pasme, është edhe më mirë, por e dimë, gjithashtu, se pesë apo gjashtë klube kanë të njëjtat ambicie", ka shtuar Conte.

# Fitojnë Golden State dhe Denveri

**BROOKLYN, 30 TETOR** - Ekipi i Golden States rikthehet te fitorja në NBA, pasi mposhti me rezultat 124-106 New Orleansin. Vendimtar për ekipin e Warriorsit, ku mungoi Stephen Curry, ishte stoli, nga ku erdhën 51 pikë. Për miqtë, dyshja Ingram-Williamson realizoi 61 pikë, por që s'mjaftuan. Fitorja e dytë radhazi për Denverin, që triumfoi me rezultat 144-139 në fushën e Brooklynit pas kohës shtesë, në një ndeshje spektakolare. Nikola Jokiq realizoi një "triple double", me 29 pikë, 18 rebounde e 16



asistime, teksa të gjithë titullarët e Denverit realizuan mbi 12 pikë. Jashtë fushës fiton edhe ekipi i Dallasit, që mundi me rezultat 120-114 Minnesotan. Për miqtë shkëlqeu Kyrie Irving, autor i 35

pikëve. Ekipi i Sacramentos, falë 28 pikëve e 11 reboundeve të Sabonis, mundi me rezultat 113-86 Utah Jazz, me këtë të fundit që nuk ka asnjë fitore në NBA këtë sezon.

### REZULTATET

Brooklyn - Denver	139-144
Minnesota - Dallas	114-120
Utah Jazz - Sacramento	86-113
Golden State - New Orleans	124-106

### SHKURT

#### Shqipëri - Çeki, shiten të gjitha biletat e ndeshjes së 16 nëntorit

Biletat e ndeshjes Shqipëri - Çeki, e vlefshme për grupin B1 të Ligës së Kombeve, janë shitur të gjitha. Stadiumi "Air Albania" do të jetë edhe këtë herë i mbushur me tifozë shqiptarë në mbështetje të Kombëtares kuqezi. Interesimi për ta ndjekur ndeshjen Shqipëri - Çeki ka qenë i lartë dhe Federata e Futbollit dëshiron t'i falënderojë të gjithë tifozët e kombëtares që kanë vendosur të jenë të pranishëm në stadiumin "Air Albania" më 16 nëntor, në mbështetje të ekipit tonë kombëtar dhe i fton të krijojnë një atmosferë të ngrohtë pozitive dhe të tregojnë qytetari dhe respekt përmes një sjelljeje korrekte ndaj ekipit kundërshtar. Njëkohësisht, Federata e Futbollit falënderon edhe të gjithë ata tifozë të cilët nuk mund të pajiseshin me bileta për këtë ndeshje dhe i fton të vazhdojnë ta mbështesin Kombëtaren shqiptare.

#### Mediet italiane vlerësojnë Ramadanin: Lider në mesfushë

Shtatë ndeshje pa fitore kishin zhytur Leccen në fundin e Serisë A. Më në fund ekipi i Ylber Ramadanit rikthehet te fitorja duke mposhtur Veronan me rezultat minimal 1-0, një ndeshje ku miqtë e mbyllën me 9-të lojtarë pas dy kartonëve të kuq. Si gjithnjë Ramadani zbriti në fushë si titullar, qëndroi në fushë për 90 minuta, duke rezultuar një nga lojtarët më të vlerësuar në radhët e Lecces: "Lider në mesfushë, administroi me qetësi çdo situatë, nuk ishte kurrë në vështirësi edhe kur ndodhej nën presion, nota 6,5 për Ramadanin", shkruajnë mediet italiane.

#### Benzema: Viniciusi e meritoi 'Topin e Artë', jo Rodri

Sulmuesi Karim Benzema ka thënë se Vinicius Junior e ka merituar "Topin e Artë" para mesfushorit Rodri. Sipas Benzemas, Rodri nuk bën asgjë të veçantë në krahasim me Viniciusin. "Fola me Vinin, është i mërzitur... është normale. E meritoi ta fitonte 'Topin e Artë'. Nuk kam asgjë kundër Rodrit, është lojtar i mirë, por kur jam në shtëpi dhe shikoj televizionin, Rodri nuk bën asgjë për të më bërë të them 'Wow', ka thënë Benzema. Për t'i qëndruar prapa Viniciusit, "Los Blancos" e bojkotoi tërë ceremoninë e "Topit të Artë", duke refuzuar të udhëtojnë për në Francë.

#### Tri klube në garë për Williamsin

Nico Williams rikthehet në modë. Sipas "Fijaches", tri klube të mëdha evropiane janë vënë në garë për t'i siguruar shërbimet e tij. Arsenali, Chelsea dhe PSG-ja janë gati të paguajnë 150 milionë euro për yllin e talentuar të Athletic Bilbaos, i cili verën e shkuar ishte shumë pranë Barcelonës. Për kampionin e Evropës (me Spanjës) ka shfaqur interesim edhe Real Madrid, por kjo vetëm përpara blerjes së Kylian Mbappe. Gjërat tashmë kanë ndryshuar. Nico Williams ende nuk ka marrë një vendim për të ardhmen, por mediet spanjolle shkruajnë se dëshira e tij është të krijojë një dyshe ëndrrash me Lamine Yamal, ashtu si në kombëtare.

## Musiala me kontratën e re do të jetë më i paguari në Bundesligë

Jamal Musiala pritet ta rinovojë kontratën me Bayern Munichun në ditët e ardhshme. Talenti gjerman ndiqet nga disa klube të mëdha evropiane dhe

për këtë arsye "bavarezët" nuk duan ta humbasin në verë. Duke ditur se kontrata aktuale skadon në verën e vitit 2026, drejtuesit kanë nisur bisedimet

me përfaqësuesit e lojtarit për zgjatjen e bashkëpunimit. Sipas raportimeve nga Gjermania, rinovimi është çështje kohe, me 21-vjeçarin që

do të bëhet më i paguari në Bundesligë. Fantazisti do të ketë një pagë edhe më të madhe se Harry Kane, i cili merr 25 milionë euro në sezon.

Kjo do ta bëjë Musialan si më të paguarin në kampionatin gjerman, ndërsa kontrata e re do të jetë e vlefshme deri në vitin 2030.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "SHNET Farmaci" SH.P.K. me seli në Viti, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812054287 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "SHNET Farmaci" D.O.O. Viti, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812054287 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "SHNET Farmaci" L.L.C. with headquarters Viti, has come to the decision to quit its business: 812054287 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- Arbnore Nushi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Burim Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Jetmir Malushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



